

Detajet e çështjes

Nr. i çështjes: 31003-03468-86-2015

Data e regjistrimit: 21-05-2015

Palët

Paditës: Petrit Imeraj

I paditur: Ministria e Mjedisit e R.SH, Drejtoria e Sherbimit Pyjor Shkoder

Objekti: Kundershtimin e aktit administrative shfuqizimin e urdherit nr 1327/8 date 21.2.2014 "per lirim punonjesi" sipas shkreses nr 3014/8 prot date 21.2.2014 te Ministrit te Mjedisit z.Lefter Koka dhe rregullimin e pasojave qe rrjedhin prej tij Detyrimin e pale

Relatori: Altina Nasufi

Gjykata Administrative e Shkallës së Parë Shkodër me vendimin nr. 96, datë 12.02.2015 ka vendosur:

- Pranimin e pjesshëm të kërkesëpadisë në këtë mënyrë:

- Të konstatojë zgjidhjen e kontratës së punës së lidhur midis palës paditëse Petrit Imeraj e palës së paditur Drejtoria e Shërbimit Pyjor Shkodër, si zgjidhje me efekt të menjëhershëm e të pajustificuar.

- Detyrimin e palës së paditur Drejtoria e Shërbimit Pyjor Shkodër, për t'i dhënë palës paditëse Petrit Imeraj, pagë e shpërblim për dëmin, si më poshtë:

1 - Pagën që do të kish fituar nëse marrëdhënia e punës do të përfundonte në fund të afatit të njoftimit, për afatin legjitim tre mujor;

2- Një dëmshpërblim prej 2 (dy) paga mujore për mosrespektim të procedurës së zgjidhjes së kontratës së punës;

3 - Një dëmshpërblim prej 19 (nëntëmbëdhjetë) paga 15 ditore për vjetërsinë në punë;

4 - Një dëmshpërblim prej 12 (dymbëdhjetë) paga mujore për zgjidhjen e menjëhershme e të pajustificuar të kontratës së punës;

5 - Pagën për 4 javë kalendarike, për lejen vjetore të pakryer për vitin 2013.

- Pushimin e gjykimit në çështjen administrative nr.679/ 590 akti, datë 16.4.2014, që është ngritur nga pala paditëse Petrit Imeraj për kërkimin për rikthimin në vendin e mëparshëm të punës, për shkakun se hoqi dorë nga gjykimi.

- Rrëzimin e kërkesëpadisë në çështjen administrative nr.679/ 590 akti, datë 16.4.2014, që është ngritur nga pala paditëse Petrit Imeraj, për pjesët e tjera si e pabazuar në ligj e në prova.

- Detyrimi për palën e paditur Drejtoria e Shërbimit Pyjor Shkodër, është i ekzekutueshëm nga përmbaruesi gjyqësor. Afati për ekzekutimin e vendimit fillon kur vendimi të marrë formë të prerë dhe mënyra e ekzekutimit të vendimit të bëhet në mënyrë të detyrueshme si për detyrimet në të holla.

- Shpenzimet gjyqësore dhe shpenzimet e procedurës së ekzekutimit e tarifa për vënien në ekzekutim, që konsiderohen pjesë e shpenzimeve gjyqësore, në masën 80 %, t'i ngarkohen palës së paditur Drejtoria e Shërbimit Pyjor Shkodër.

- Kundër këtij vendimi lejohet apel, brenda 15 ditëve nga e nesërmja e shpalljes. Për palët/aktorët në mungesë, afati fillon nga dita e njoftimit të vendimit.

Gjykata Administrative e Apelit, vendosi:

- Lënien në fuqi të vendimit nr. 96, datë 12.02.2015 të Gjykatës Administrative të Shkallës së Parë Shkodër. - Kundër këtij vendimi lejohet rekurs në Kolegjin Administrativ të Gjykatës së Lartë, brenda 30 ditëve afat që fillon nga e nesërmja e njoftimit të vendimit. Tiranë, më 05.04.2017

Data e shpalljes: 05-04-2017